# DËSHMI ARKIVI

**A-471881**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Wendt në Tiranë, ambasada amerikane zbardh detaje pas takimit me Begajn: Diskutuan për çuarjen për para të përparësive të administratës Trump |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/26/wendt-ne-tirane-ambasada-amerikane-zbardh-detaje-pas-takimit-me-begajn-diskutuan-per-cuarjen-perpara-te-perparesive-te-administrates-trump/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 15:18:00 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 15:14:43 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ee611257fea0b430c29aa940287b43357bb7b7fed74b99e27a516267e2ddb896` |
| TEKSTI | `e6d2e01c17db05d1410f339e58ec68b932fb80691847022efca0d0732f0b5c9e` |
| PAMJA | `a1695bfa8b5bfd09d1016c9c1860a1cd2c058d4d43d7fb9e83b16d08006d12ac` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ab61ac158a68fec4283e48fa10f511f0e0093163991224a3f12f9df34c6a25a2` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c646a932fde53c288233dea515333d4375993381cb212e1a0a5e6c9db33460b4` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ab61ac158a68fec4283e48fa10f511f0e0093163991224a3f12f9df34c6a25a2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Wendt në Tiranë, ambasada amerikane zbardh detaje pas takimit me Begajn: Diskutuan për çuarjen përpara të përparësive të administratës Trump

Politikë

Publikuar: 26/09/2026



Ambasada amerikane njoftoi përmes një publikimi në Facebook dorëzimin e letrave kredenciale nga ambasadori Eric Wendt te Presidenti Bajram Begaj, duke shënuar kështu nisjen e misionit të tij diplomatik në Shqipëri.

“Mirë se vjen, Ambasador Wendt! Ambasadori i ri i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, Eric Wendt, i paraqiti letrat kredenciale Presidentit Bajram Begaj. Ambasadori Wendt dhe Presidenti Begaj riafirmuan partneritetin e fortë mes Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë dhe diskutuan për çuarjen përpara të përparësive të administratës së Presidentit Donald J. Trump, përfshirë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, rritjen ekonomike dhe luftën kundër grupeve kriminale transnacionale”, thuhet në mesazh.

Pa kaluar 24 orë nga mbërritja në Rinas, paraditen e së shtunës, Wendt mbërriti te Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, të shtunën në mëngjes.

Pas ceremonisë së zhvilluar në ambientet e Pallatit të Brigadave, Wendt zhvilloi një takim kokë më kokë me Presidentin Begaj. Takimi, sipas burimeve, zgjati gati një orë, ndërsa nuk u bënë të ditura temat e diskutuara.

Diskutimi mes Wendt dhe Begajt vjen dy ditë para mbledhjes së Këshillit të Sigurisë Kombëtare, të thirrur nga Presidenti për shkak të situatës së krijuar pas vendimit për lënien në “arrest shtëpie” të ish-drejtueses së SHISH, Vlora Hyseni.

TAG: Ambasada amerikane | Bajram begaj | Eric Wendt

Më të lexuarat


Ish-shefja e SHISH/ Nuk shantazhoi median, por kërcënoi armiqtë e saj


Historia e dyshimtë e ankandit të Llatjas, si u bë Kujtim Llupa pronar i Klubit të Ekotasahit?


33-katëshi në Vlorë/ Ardi Kollçaku, marrëveshje me “grupin e kokainës” për “Kullën e Tiranës”


40 milionë euro tendera / Kush është fierakja Diana Laba që vjedh paratë e bashkive me punime fik...


CIA jep alarmin: Rusia po përgatit sulme me dronë ndaj Italisë, Spanjës dhe Francës

## Të ngjashme



“Shkova bashkë me Argitën” – E akuzoi se ka kaluar nga zyra e Agasit, Berisha “zbythet” ndaj ministres Ismaili: Ishte…

“Non Grata” nga SHBA, Berisha s’ka ftesë për ceremoninë e prezantimit të Eric Wendt si ambasador!

Balla nga selia e OKB: Nën drejtimin e Kryeministrit Rama, Shqipëria është ngjitur në majën më të lartë të historisë së saj shtetërore

# Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

# Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

# Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT

Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.